

VENDIM
Nr.791, datë 16.12.2005

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.205, DATË 13.4.1999 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E DISPOZITAVE ZBATUESE TË KODIT DOGANOR”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8449, datë 27.1.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.205, datë 13.4.1999 të Këshillit të Ministrave, në nenin 531 të seksionit 13 “Dhurata të dhëna në kuadër të marrëdhënieve ndërkombëtare”, të kreut II “Rrethana të veçanta për të cilat jepet përjashtim nga detyrimet doganore”, të pjesës III “Përjashtime nga detyrimet doganore”, në shkronjën “ç”, pas shprehjes “...Forca të Armatosura”, të shtohet shprehja “...dhe strukturave të Policisë së Shtetit”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha